

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ____/____/ 2024



KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

DIVIZIONI TEKNIK

DEPARTAMENTI ELEKTRO-MEKANIK

TERMA REFERENCE DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

“Riparimi i dëmtimeve të turbinave të AG1 dhe AG3 në HEC Fierzë dhe 5 agregatet në HEC Vau i Dejës”

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. KËRKESA TË PËRGJITHSHME.....	3
3. SPECIFIKIME TEKNIKE	3
4. PUNA PËRGATITORE	4
5. SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË	4
6. DËMTIMI I ELEMENTËVE/SISTEMEVE TË HEC-EVE	4
7. MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT	4
8. STAFI TEKNIK.....	4
9. STANDARTE DHE DIREKTIVA	4
10. PAJISJE DHE MAKINERI	5
11. MBËSHTETJA QË DO TË OFROJË KESH SH.A	5

1. HYRJE

Këto specifikime teknike, së bashku me dokumentacionin teknik të bashkangjitur, përfshijnë kërkesat minimale për realizimin e objektit: “Riparimi i dëmtimeve të turbinave të AG.1 dhe AG.3 në HEC Fierzë dhe i dëmtimeve të turbinave të 5 (pesë) agregateve në HEC Vau i Dejës”.

Bazuar në eksperiencën disa vjeçare të punimeve të kryera në eliminimin dëmtimeve tek rrotat e punës tek agregatet nr.1 dhe nr.3 HEC Fierzë dhe punimeve tek rrotat e punës dhe tubacionet e prishjes së vakumit në HEC Vau i Dejës del domosdoshmëri paraprirja e procedurave për kryerjen e këtyre punimeve. Gjatë eksperiencës shumëvjeçare në kryerjen e remonteve, kontrolleve dhe inspektiveve në dhomat spirale, tubat thithës, në rrotat e punës, aparatet drejtues, tubacionet e prishjes së vakumit janë konstatuar se dëmtimet nga fenomeni i kavitacionit dhe lodhjes së materialit janë në disa zona.

2. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Për realizimin me sukses të këtyre punimeve, kontraktori ndër të tjera duhet të realizojë:

- Kontraktori duhet të shqyrtojë relacionin teknik paraprak dhe mënyrën e realizimit të punimeve që përpara lidhjes së kontratës me KESH sh.a.
- Kontraktori do të jetë përgjegjës për kontrollin dhe duhet të verifikojë informacionin paraprak që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët dhe në mospërputhje me gjendjen aktuale në objekt.
- Kontraktori ka detyrimin të përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për të realizuar inspektimin e përbashkët në prani edhe të supervizorit me qëllim vlerësimin e gjendjes teknike dhe llogaritjen e preventivit të punimeve përpara se të fillojnë punimet për realizimin e punimeve.
- Kontraktori ka detyrimin që gjatë inspektimit të përbashkët të ofrojë mbështetjen e tij me personel të specializuar si dhe pajisje/materiale, me qëllim gjetjen dhe vlerësimin e dëmtimeve që mund të jenë të pranishme në turbinë, aparat drejtues dhe në tubacionet e prishësave të vakumit.
- Kontraktori duhet të japë asistencën e tij teknike tek punëdhënësi pas kontrollit të kryer në rrotën e punës dhe aparatit drejtues dhe të përcaktojë qartë mënyrën e realizimit të punimeve.
- Kontraktori gjatë fazës së zbatimit të punimeve duhet të bëjë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme, konsulta me personelin inxhiniero-teknik të objektit, të dokumentojë dhe fotografojë të gjithë proceset e punës sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit të punimeve në mënyrë që të demonstrojë progresin e punës, cilësinë e materialeve të përdorura dhe punimeve të kryera, kushtet e punës, etj.

3. SPECIFIKIME TEKNIKE

- Të gjitha dokumentet teknike që shoqërojnë këto punime do të jenë bazë për vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së punës që do të bëhet për zbatimin e tyre.
- Çdo ndryshim apo përshtatje me kushtet aktuale do të bëhet vetëm në bashkëpunim me grupin teknik, supervizorin e punimeve dhe me aprovim të KESH sh.a.
- Kontraktori gjatë realizimit të saldimeve, prerjeve dhe proceseve të tjera do të mbështetet dhe do të respektojë standardet SSH, ISO ose ekuivalentet e tyre.
- Kontraktori në fund të çdo operacioni pune si, çarje kanali për realizimin e saldimit, punimeve të saldimit, do të bëjë kontroll të procesit të realizuar me metodat pa shkatërrim (NDT) nga personel i certifikuar dhe pasi të bindet se nuk ka probleme të vazhdojë me proceset e tjera pasardhëse.

- Materialet dhe pajisjet që do të përdoren gjatë kryerjes së punimeve duhet të shoqërohen me certifikatë cilësie të mallit.
- Materialet dhe pajisjet që do të përdoren duhet të përputhen me standardet kombëtare ose ekuivalente të cilësisë dhe gjithashtu të jenë të tilla që ti rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lagështirës.
- Në fund të proceseve të punës do të bëhet kontrolli me metodat pa shkatërrim (NDT) nga personel i certifikuar i të gjithë rrotës së punës, aparatit drejtues, prishësave të vakumit dhe zonat tek tubi thithës dhe zonave të tjera objekt kontrate.

4. PUNA PËRGATITORE

- Përpara se të kryhen proceset e punës së kërkuar në ambientet e brendshme, zona duhet të jetë e pastruar dhe sipas rregullave të sigurimit teknik dhe sigurisë në punë.
- Asnjë proces pune nuk duhet të kryhet derisa mbikëqyrësi i punimeve të ketë inspektuar dhe aprovuar masat e duhura për fillimin e punës sipas kushteve teknike të dhëna më sipër.

5. SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË

Është detyrë dhe përgjegjësi e kontraktorit që garantojë kushtet e nevojshme sipas parashikimeve të kodit të punës për punonjësit e vetë që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Çdo aksident i mundshëm në punë do të jetë përgjegjësi e kontraktorit.

6. DËMTIMI I ELEMENTËVE/SISTEMEVE TË HEC-EVE

Gjatë punimeve kontraktori duhet të tregoj kujdes në mënyrë që mos të shkaktojë ndonjë dëmtim të elementëve objekteve apo sistemeve përbërës në zonën ku do punojë. Në rast se gjatë punimeve, kontraktori do të shkaktojë ndonjë dëmtim të elementëve të sipërpërmendur, është detyrë e tij që të realizojë riparimin/ zëvendësimin me kostot e veta.

7. MBROJTJA KUNDËR ZJARRIT

Meqenëse proceset e punës janë, pastrim, axhustim dhe saldim të cila shoqërohen me temperatura të larta, është e nevojshme që të merren masa për mbrojtjen kundër zjarrit.

Është detyrë e kontraktorit që të instaloj në zonën e punës pajisje të tilla të përkohshme të cilat do të shërbejnë në rast të rënies së zjarrit gjatë punimeve.

8. STAFI TEKNIK

Kontraktori duhet të ketë pjesë të stafit teknik inxhinier mekanik, saldator dhe axhustator me eksperiencë në këtë fushë.

Saldatorët duhet të jenë të kualifikuar sipas standartit SSH EN ISO 9606-1 ose ekuivalent.

9. STANDARTE DHE DIREKTIVA

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë minimalisht certifikatat sipas standardeve të mëposhtme ose ekuivalentet e tyre:

- SSH EN ISO 9001:2015 - Sistemi i menaxhimit të cilësisë
- SSH EN ISO 14001:2015 - Sistemi i menaxhimit të mjedisit
- SSH EN ISO 45001:2018 - Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të jenë në përputhje me pikën 3 të nenit 44 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

10. PAJISJE DHE MAKINERI

Nisur nga natyra e punimeve, afati kohor i realizimit dhe cilësia e realizimit vlerësohet që për realizimin me sukses të punimeve është e nevojshme që të përdoren minimalisht pajisjet dhe makineritë e mëposhtme.

NR.	EMËRTIMI
1.	Pajisje për prerje me elektroda karboni
2.	Pajisje saldimit për elektroda inoksi
3.	Furrë tharje për elektroda
4.	Pajisje axhustimi
5.	Pajisje për shpimin në zonat e lopatave të rrotës së punës
6.	Kamionçinë e pajisur me vinç 1 - 1.5 ton

11. MBËSHTETJA QË DO TË OFROJË KESH SH.A

Për inspektimet dhe investigimet e përshkruara në aktivitetet e parashikuara, KESH sh.a do të sigurojë të gjitha kalimet, lejet etj, përpara mobilizimit nga kontraktori të personelit teknik dhe pajisjeve.